



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

**KOMUNA E DEÇANIT**  
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe  
Shërbime Publike

09 Nr. \_\_\_\_\_ 2020

Dt. 13 / 01 / 2020

## RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2019

### Periudha Janar- Dhjetor

	DEÇANI - DEÇANE - DEÇAN REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANE - DEÇAN MUNICIPALITY
Nr. i Dreg. / Org. Jed. / Org. Unit:	<u>Daj. Mb. Mjet. 1005</u>
Nr. i Fsheve / Sh. Stranice / No. pages:	<u>09</u> / <u>B.01.20</u>
DEÇAN DEÇANE	

Punoj:  
Shefi për Shërbime Publike  
Xhevat Lufaj

Miratoj:  
Drejtori për Mbrojtje, Shpëtim dhe Sh.Publike  
Izet Zenuni



## SEKTORI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim në periudhën Janar – Dhjetor 2019 aktivitetet e veta i ka planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit i ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027 , Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012, Ligjin për Zjarre fikje dhe Shpëtim Nr. 04/-L-049, Udhëzimet Administrative si dhe Planin e Punës për vitin 2019.

### Planet e azhuruara

#### Duke u bazuar në Planin vjetor të punëve dhe detyrave të planifikuara për vitin 2019

Zyra e ZAKE-es pranë Drejtoratit për Mb. Sh. Dhe Shërbime Publike gjatë vitit 2019 , ka kryer këto punë dhe detyra me sa vijon :

- Hartimi i Planit të vjetor të punës për vitin 2019.
- Analiza dhe raporti i punës për vitin 2019, përgatitja e performancës komunale për vitin 2019.
- Hartimi i raporteve mujore të punës.
- “Pikat më vërshuese nga të reshurat atmosferike në territorin e Komunës së Deçanit”
- “Vlerësimi i rreziqeve nga shembjet dhe erozioni në Komunën e Deçanit”
- “Vlerësimi i rrezikshmërisë së rrjetit elektrik në K. Deçanit”
- “Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit”
- Punë dhe detyra të veçanta sipas kërkesës.

Planet e mbrojtjes për shkollat fillore dhe të mesme (pjesërisht) si dhe Plani i Mbrojtjes për Kuvendin Komunal dhe QKMF-së.

Hartimi i Planit të punës për vitin 2019

Analiza e punëve dhe detyrave të planifikuara dhe të realizuara për vitin- 2019

Raporti mbi punët dhe detyrat e realizuara gjatë vitit – 2019

- Përgatitja e Dokumentacionit (lëndëve të miratuara ) gjatë vitit 2019 për Arkivim.
- Punë dhe detyra shtesë sipas urdhrat të Drejtorit .
- Inspektime dhe dalje në teren me bashkëpunëtorët e Drejtorisë.
- Komunikim me telefon për punë të ndryshme zyrtare.
- Marrja e informatave nga NJ. P. Z. Sh. sipas nevojë.
- Raportimi i informacioneve në QRAKE-Pejë sipas nevojë.
- Hartimi dhe azhurimi i listave të subjekteve me rëndësi të veçantë për komunikim.
- Azhurimi në INTRANET i kërkesave të qytetarëve dhe organizatave të ndryshme të cilat adresohen në Drejtorinë për Mbrojtje ,Shpëtim dhe Shërbime Publike.

- Përgjegjje në kërkesat e pranuar nga qytetarët dhe organizatat e ndryshme me shkrim dhe adresimi i tyre.
- Kërkesa për furnizim me materiale shpenzuese për Drejtorinë e Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike si dhe NJPZSH-Deçan.
- Ushtrimi dhe demonstrimi i rasteve emergjente me titull, "SHPATA E ARGJENT" në bazën e KROR-it në Prishtinë.
- Trajnim dy ditorë pranë MAP-Instituti i Kosovës për Administratë.
- Inspektime me rastin e të reshurave që kanë ndodhë gjatë muajit nëntor në disa lokalitete të fshatrave në Komunën e Deçanit.
- Menaxhimi i kontratës për mirëmbajtjen e kanalizimit të ujërave të zeza sipas kontratës së komunës dhe përfundimi i kontratës në shtator.
- Evidentimin, identifikimin, strehimin, kujdesin dhe akomodimin e personave të ardhur në komunën e Deçanit pas tragjedisë së tërmetit në shtetin e Shqipërisë, ku secila familje është evidentuar me formularë të posaçëm.
- Menaxhimi i projektit për stolisjen e Qytetit të Deçanit me rastin e festave të ndryshme dhe mirëmbajtje e Lapidarëve të Dëshmorëve në territorin e Komunës së Deçanit.
- Mirëmbajtja dhe riparimi e kamerave të qytetit gjatë vitit
- Përgatitja e planit vjetor të punës për vitin 2020

Shënim:

-Radiolidhjet e dorës janë jashtë funksionit për shkak të baterive të shpenzuara si dhe Radiolidhjet bazë nëpër BL janë të demoluara pjesërisht.

-Të njëjtat kanë nevojë për servisim komplet i tërë rrjeti i komunikimit.

### **Dalje në teren, rekomandime, njoftime**

Gjatë vitit 2019 sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim ju ka përgjigjur kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve duke dal në teren dhe duke shikuar për së afërmi problemet.

Gjithashtu, janë shikuar për së afërmi edhe pikat të rrezikut cilat në raste të caktuara mund të paraqesin rrezik për qytetarët.

Përgatitja e fazës së dytë për vendosjen e kamerave në qytetin e Deçanit.

Grumbullimi i të dhënave për aparatet për shuarjen e zjarrit të i posedojnë të gjitha shkollat dhe objektet e institucioneve tjera në komunën e Deçanit.

## Të përgjithshme

1. Pjesëmarrje në takimet e KKSB-së ku si temë kryesore ka qenë siguria në komunën e Deçanit.
2. Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka realizuar edhe detyrat tjera të përditshme, ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha drejtoritë komunale, me komunat në regjion, Institucionet Qendrore, sidomos me AME, FSK-në, Policinë e Kosovës, KFOR-in, Kryqin e Kuq, dhe OJQ-të.
3. Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me NJPZSH-në si dhe përgjigje ndaj të gjitha kërkesave të tyre.
4. Evidentimi i të gjitha rreziqeve të mundshme në tërë territorin e komunës së Deçanit.
5. Bashkëpunimi me zyrtarët e drejtorisë.
6. Përgatitja e masave parandaluese si dhe njoftimi nga aspekti i MNZ-së në pyje dhe sipërfaqe fushore gjatë sezonit të korrije shirjeve.
7. Përgatitja e dokumentacionit (lëndëve të miratuara) gjatë vitit 2019 për arkivim.

## Sektori për Shërbime Publike

Bazuar në planin vjetor të punës të planifikuara për vitin 2019, Sektori për Shërbime Publike në vitin 2019 ka kryer këto punë dhe detyra :

### 1. Aktivitete të planifikuara dhe të bazuara në planin vjetor të punës për vitin 2019

-Organizimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e punëve në fushën e shërbimeve publike, duke i zbatuar ligjet dhe rregulloret në fuqi për ofrimin e shërbimeve sa më të mira publike për qytetarët e komunës sonë.

-Përcjellja e vazhdueshme e punimeve të SH.A. "Higjiena" që është e kontraktuar për mbledhjen, grumbullimin dhe heqjen e mbeturinave në hapësirat publike komunale.

-Mbikëqyrja e mirëmbajtjes verore / dimërore të rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe fshatra, planifikimi, përcjellja dhe menaxhimi i kontratave për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve.

-Mirëmbajtja e kanalizimit i ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike si dhe vendosja e kapakëve të pusetave, ndërrimin e gypave pastrimin e pusetave të ujërave atmosferike.

-Menaxhimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik.

-Menaxhimi i kontratës për stolisjen e qytetit të Deçanit gjatë festave të ndryshme.

## **2. Projekte të realizuara gjatë vitit 2019**

-Në bazë të memorandumit për menaxhimin e mbeturinave të nënshkruar në mes Kryetari të komunës dhe GIZI-it gjerman ka vazhduar bashkëpunimi ku është bërë shtrirja e shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në tërë territorin e komunës së Deçanit të gjitha ekonomive familjare si dhe bizneseve nga kompania komunale SH.A “Higjiena”.

-Gjithashtu është duke implementuar Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe planit operativ, plan i cili është duke vazhduar.

-Komuna e Deçanit ka furnizuar kompaninë Higjiena me pesë kamionë si dhe ka filluar ndërtimi i objektit të kompanisë.

-Është bërë identifikimi i të gjitha deponive ilegale që janë në territorin e komunës së Deçanit, si është hartuar projekti për eliminimin e këtyre deponive dhe është duke u zbatuar. Janë eliminuar deponitë më të mëdha siç janë: deponia te ura në mes fshatrave Prapaqan- Llukë e Ulët, te ura Llukë e Epërme – Isniq dhe deponia në oborrin e Hidro – Drini, të cilat janë rrethuar si dhe bërë mbjellja e barit dhe janë shndërruar në hapësira gjelbëruese si dhe janë mbjelluar fidanë të pishë së zezë në deponitë e pastruara te ura në mes fshatit Lumbardh – Broliq, te ura në mes fshatit Isniq – Llukë e Epërme si dhe në fshatin Baballoq.

Mirëmbajtja e hapësirave publike të gjelbëruara (parqeve , shesheve) në qytet dhe në fshatra.

-Bashkëpunim pune me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare si me USAID-in, OSBE-në, Giz-in, me Ministrinë e Transportit, Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinore, me ndërmarrjet publike komunale dhe regjionale, me inspektorët nga Ministria e Punëve të Brendshme, inspektorët e rajonit etj.

Zbatimi i planit për Energji efikiente si dhe përfundimi i projektit për ndriqim publik efikient në qytetin e Deçanit dhe në zonat rurale.

- Përfundimi i projektit të kanalizimit në fshatin Pobërgjë, Lagj. Mataj- Hadërgjonaj 920 m
- Përfundimi i projektit të kanalizimit në rrugën “Çamëria” 96.6 m
- Përfundimi i projektit të kanalizimit në fshatin Rastavicë 421.5 m
- Përfundimi i projektit të kanalizimit në fshatin Carrabreg i Epërm 874 m
- Përfundimi i projektit të kanalizimit në rrugë “Metë Sylt” 780 m
- Përfundimi i projektit të kanalizimit në rrugë “Haki Povataj” 800 m
- Përfundimi i projektit të kanalizimit në rrugë “Nagip Cacaj” 374.3 m

-Pranimi teknik i rrugës “ Kilaj “ me gjatësi prej 1400 m plani dinamike për dy vjet i realizuar ne periudhën kohore prej 1 viti.

-Asfaltimi i aksit 1 te rrugës “ Belle” segmenti gjatësore prej 1500 m ,ndërsa pjesa tjetër ka filluar me muret mbrojtëse.

-“Lot- 2”, punë kryersi “Arfa Group” sh.p.k deri me tani kemi realizuare 28495 m rruge duke i përfshire edhe kanalet për ujitje ne gjatësi prej 500 m prej 28.495 m te hapura janë asfaltuare deri me tani 11.635 km pjesa tjetër është ne përgatitje e sipër.

-Në kuadër te mirëmbajtjes verore me kompaninë “ Lika Trade “ kemi realizuar punime prej te cilave vetëm asfaltim kemi 5.3 km kurse shërbime te tjera janë: largim te dheut ,furnizim me zhavorr, kanale për ujitje etj.

-Në kuadër te Eficiences kemi përfunduar Planin për Energji te Eficiences përkatësisht draft planin i cili është miratuar ne Asamblenë Komunal ,si dhe jemi ne përfundim te dhënave për objektin e Komunës për tenderim në kuadër te Agjensionit.

-Bashkëpunim pune me organizatat ndërkombëtare si me USAID-in, OSBE-en, Giz-in, ASA-n etj., si dhe trajnime, për Efiçincën e Energjisë.

-Raportimi i vazhdueshëm për përmirësimin e Energjisë Efiçiente.

Fillimi i punimeve ne Rrugën e Qendrës, hapja e trasesë ne gjatësi prej 1000 m ,si dhe asfaltimi i kësaj gjatësi prej 1000 m ose 1 km. Punimet vazhdojnë sipas dinamikës se parapare.

Asfaltimi i rrugicave ne fshatin Irzniq ,ku hapja e trasesë është bere ne tërë segmentin e parapare sipas kontratës prej 3.2 km , është kryer asfaltimi i një pjese prej 900m është përfunduar dhe kanale për ujitje prej 120m gjatësi pjesa tjetër është duke u trajtuar sipas para masës dhe parallogaritje.

Fillimi i punimeve ne Rrugën për bjeshkën e Strelcit me një gjatësi prej 10 km ,kanë filluar punimet, janë ndërprere për shkaqe te projektit, i cili duhet te revidohe, punimet vazhdojnë ne pranvere .

## Inspektori i parandalimit nga zjarri

Raporti i punëve të kryera gjatë periudhës 01.01.2019 – 31.12.2019

- Hartimi i raportit të punës për periudhën 01.01.2019 gjer 31.12.2019 i cili është prezantuar Drejtorit të Drejtoratit për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike dhe dërguar edhe A.M.E -në Prishtinë.
- Hartimi i Planit të punës i detajuar për periudhën 01.01. 2020 gjer 31.12.2020 për Drejtorit të Drejtoratit për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime dhe dërguar edhe A.M.E në Prishtinë.
- Në fillim të çdo muaji të periudhës së parë dhe të dytë të vitit kalendarik, janë hartuar Planet e punës për vitin kalendarik dhe çdo herë me shkrim është njoftuar edhe Drejtori i Drejtoratit për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime dhe AME- Departamenti i parandalimit Prishtinë
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën e tre mujore të vitit 2019
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën gjashtë mujore të vitit 2019
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën nënte (9) mujore të vitit 2019
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën dymbëdhjetë mujore për vitin 2019

**Njoftime për menaxherë te objekteve , në të cilat janë kryer inspektimet e rregullta , se për të njëjtat ka përfunduar procedura ligjore për masat e mbrojtëse nga mbrojta e zjarrit të Urdhëruara me Vendim .**

- Me këto shkresa janë Njoftuar gjithsejtë = 00

### **1. INSPEKTIMET :**

- Inspektime fillestare : gjithsejtë .... 00
- Inspektime të rregullta : gjithsejtë..... 3
- Inspektime verifikues : gjithsejtë..... 1
- Inspektime i jashtëzakonshëm: gjithsejtë..... 16
- Inspektime fillestare, jashtëzakonshme, verifikuese .....gjithsejtë = 20
- Deklarime gjithsejtë = 00
- Akte përcjellëse gjithsejtë = 00

### **2. VENDIMET MBI MASAT E URDHËRUARA**

- Hartimi i Vendimeve mbi masat e urdhëruar nga mbrojtja e zjarrit **gjithsejtë = 00**

### **3. VENDIMET PËR NDËRPRERJEN E PËRKOSHME TË PUNIMEVE NË OBJEKTE:**

- Vendime mbi ndërprerjen e përkoshme të punimeve **gjithsejtë = 0**

### **4. DALJA NË TEREN PËR SHIKIMIN E VENDIT KU PARASHIHET TË NDËRTOHEN OBJEKTET E NDRYSHME:**

- Dalja në teren **gjithsejtë = 3**

### **5. HARTIMI I PROCESVERB. PËR SHIKIMIN NË DOKUM. INVESTIVO TEKNIK PËR OBJEKTE TË NDRYSHME:**

- Procesverbale të tilla janë **gjithsejtë = 3**

**6. DHËNJEN E PËLQIMEVE NË DOKUMENTACIONIN INVESTIVO TEKNIK PËR OBJEKTE TË NDRYSHME.**

- Pëlqimet e të tilla janë **gjithsejtë = 2**

**7. DHËNIA E PËLQIMEVE NË RREGULLOREN E BRENDSHME nga MNZ PËR OBJEKTET E NDRYSHME:**

- Pëlqime të tilla janë **gjithsejtë = 0**

**8. DHËNIA E PËLQIMEVE NË PLANIN E MBROJTJES NGA ZJARRI :**

- Pëlqime të tilla nuk kemi pasur gjatë kësaj periudhe. **gjithsejtë = 0**

**9. AUTORIZIMET:**

- Hartimi i autorizimeve të lëshuara nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri komfor Ligjit për mbrojtje nga zjarri 04/L-012- 2011 **gjithsejtë = 1**

**10. KONSTATIMI DHE VERIFIKIMI I ZJARREVE:**

- Konstatimi, verifikimi dhe hulumtimi i shkaqeve të zjarrit dhe dalja në vendin e ngjarjes me rastin e shpërthimit të zjarrit gjatë periudhës 12 mujore **gjithsejtë = 168** zjarre.

**11. VËRTETIME:**

- Në bazë të kërkesa të parashtruara nga palët lidhur me lëshimin e dëshmisë se ka pasur zjarr në palujtshmerit e tyre: **gjithsejtë = 3**

**12. HARTIMI I KËRKESAVE PËR PLOTËSIM LËNDE:**

- Përpilimi dhe dërgimi i kërkesës për plotësim lënde **gjithsejtë = 4**

**13. HARTIMI I RAPOPRTJEVE PËR ZJARRET E NDODHURA DHE KERKESAVE TJERA DËRGUIAR POLICISË SË KOSOVES Stacioni POLICOR NË DEÇAN**

- **Gjithsejte = 16**

**14. SHKRESA DËRGUIAR A.M.E-ës NË PRISHTINË:**

- Shkresa të tilla dërguar A.M.E-ës **gjithsejtë = 0**

**15. HARTIMI I SHKRESAVE PËR DREJTORATIN PËR MBR.SHP. DHE SHËRB. PUBLIKE :**

- Sipas kërkesës së kësaj kemi hartuar **gjithsejtë = 3** shkresa.

**16. REFUZIMI I KËRKESAVE :**

- Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur lëndë të cilat është dashtë të refuzohet kërkesa .

**17. HARTIMI I KËRKESAVE PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KUNDËRVATJE:**

- Hartimi i kërkesave për fillimin e procedurës për kundërvajtje: **gjithsejtë = 0**

**18. MBROJTJA E LËNDEVE ME RASTIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS PËR KUNDËRVATJE NË GJKATËN KOMPETENTE:**

- Mbrojtja e lëndëve me rastin e fillimit e procedurës për kundërvajtje në Gjykatën kompetente **gjithsejtë = 0**

- Në librin e protokollit të shkurtër janë evidentuar 30 shkresa si: Akte përcjellëse, Autorizime, Ftesa për palët, Njoftime për përfundimin e procedurës ligjore, Konkluzionet , kërkesa për plotësim lënde e tjera, të cilat punë kanë qenë të pa planifikuara mirëpo janë të domosdoshme gjatë zhvillimit të procedurës ligjore.
- Takime pune dhe konsultime e Drejtoratit për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime KK-Deçan dhe takime tjera me A.M.E –en – Departamenti i parandalimit ndaj zjarrit në Prishtinë.
- Takime punë me zyrat e parandalimit ndaj zjarrit me Komunat fqinjë. Takime zyrtare me përfaqësuesin juridik të objekteve me rëndësi të veçantë nga mbrojtja e zjarrit.
- Ushtrimi dhe demonstrimi i rasteve emergjente me titull “SHPATA E ARGJENT” ne bazën e KFOR-it në Prishtinë.
- Trajnimi dy ditor pranë MAP, Instituti i Kosovës për Administratë..
- Menaxhimi i kontratës për Blerjen e kamionëve për mbeturina me numër Prot.02/19936 dt. 20.06.2019.
- Kryerja e disa punëve të përditshme administrative: si përgatitja e fletë dorëzimeve, dërgimi i shkresave palëve në procedurë nëpërmjet shërbimit të postës dhe direkt në dorë, përgatitja e thirrjeve për palët në procedurë, konsultime me palët , evidentimi në regjistrat e inspektimeve e tjera.

## **RAPORT PUNE PËR VITIN 2019 NGA ZYRTARI PËR TRANSPORTIN PUBLIK DHE RRUGË LOKALE**

Gjatë periudhës nga 01.01 2019 deri me 31.12.2019 nga Zyrtari për transportin lokalë dhe rrugë lokale, ka kryer këto punë dhe detyra:

- Hartimi i Planit Vjetor të Punës për Vitin -2019;
- Hartimi i Planit mujorë të punës për vitin -2019;
- Bashkëpunimi me subjektet me rendësi të veçantë (Policin e Kosovës, Inspektoratin e Ministrisë, përfaqësues të komuniteteve) etj.
- Bashkëpunimi me M.T.P.T.K. dhe zyrës nder komunalë;
- Koordinimi mbi aktivitetin e transportit publik të mallrave dhe udhëtareve me kompanitë publike dhe taksitë individual;
- Caktimi i linjave për bartjen e udhëtareve në trafikun urban;
- Dhënia e pëlqimit për regjistrimit e taksistëve sipas rregullores se komunikacioni;
- Bashkëpunimi me Policin e trafikut për lirim të trotuareve nga automjetet;
- Caktimi i drejtimeve rrugore për qarkullimin e automjeteve në zonën urbane dhe lokacionet e limituara për parkingje;
- Përkujdesja për shënjimin vertikal dhe horizontal të rrugëve lokale;
- Propozimi për mbylljen e përkohshme të rrugëve në rast nevojë (festa ,protesta) etj.
- Kujdesia për renovimin e rrugëve lokale si atyre të asfaltuara ashtu edhe të atyre të pa asfaltuara;
- Njoftimi sipas nevojë M.T.P.T.K. për riparimin e shenjave, defektet në rrugët ndër komunale;
- Përkujdesja për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe shesheve në sezonin dimëror;
- Lëshimi i lejeve për vendosjen e pengesave në rrugë që janë kompetencë e Komunës;
- Kryerja e punëve të tjera sipas ligjit dhe rregullores në fuqi dhe kërkesave të drejtorit dhe departamentit të cilave iu përgjigjet në punë.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për  
Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

09 Nr. \_\_\_\_\_ 2019  
Dt. 10 / 12 / 2019

Për/To/Za :	Kryetarin e Komunës z. <b>Bashkim Ramosaj</b>
CC :	
Përmes/Through/Preko:	Drejtori për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike z. <b>Izet Zenuni</b>
Nga/From/Od :	Komisioni për evidentimin e personave të ardhur nga Shqipëria në komunën e Deçanit
Tema/Subject/Subjektat	<b>R A P O R T</b>




-Me rastin e fatkeqësisë natyrore (termet) që ka ndodhur me dt.26.11.2019 rreth orës 03:55 të mëngjesit me epiqendër në qytetin e Durrësit në Republikën e Shqipërisë. Kryetari i komunës së Deçanit në bazë të kompetencave ka nxjerrë vendim me dt.29.12.2019 për formimin e komisionit për identifikimin, strehimin dhe akomodimin e personave të ardhur në territorin e komunës së Deçanit.

-Komuna e Deçanit në aspektin financiar ka grumbulluar shumën prej 20.580,00 € për të prekurit në shtetin e Shqipërisë, ndërsa shuma prej 5.000 € komuna i ka ndarë për familjen Abazi nga komuna e Gjilanit, po ashtu në veshmbathje dhe gjëra ushqimore janë dërguar 7 kamion.

-Sa i përket të strehuarve në komunën e Deçanit janë strehuar mbi 35 familje por komisioni ka të dhëna vetëm 15 familje me gjithsej 73 banor.

-Komuna për këto familje ka siguruar gjëra ushqimore, veshmbathje, asistencë mjekësore si dhe ka siguruar medikamente të nevojshme.

-Qytetaret e komunës sonë kanë shprehur gatishmëri që t'i strehojnë të ardhurit nga shteti i Shqipërisë, gjithsej janë paraqitur rreth 60 familje për të cilët komuna disponon një listë të veçantë.



**Komisioni pas verifikimit në teren ka këto të dhëna:**

- |  |   |
|--|---|
| 1. Beqë Hadergjonaj – Deçan (3 familje) –          | Mondi Qela (5 anëtar);<br>Ledi Lela (5 anëtar);<br>Arben Qela (2 anëtar); |
| 2. Milaim Qorraj – Carrabreg i Ulët (1 familje) –  | Mihail Karanxhi (3 anëtar);   |
| 3. Rexhep Loshaj – Carrabreg i Epërm (2 familje) – | Xho Jakupi (3 anëtar);<br>Kujtim Boqi (5 anëtar);                         |
| 4. Arif Demhasaj – Leđina (1 familje) -            | Esat Ramsaliu (8 anëtar);   |
| 5. Demë Kameraj – Lëbushë (2 familje) -            | Besnik Shahini (5 anëtar);<br>Shkëlqim Kardhiqoti (2 anëtar);             |
| 6. Skender Mulaj – Llukë e Epërme (1 familje) -    | Teodor Çuni (5 anëtar);   |
| 7. Skender Haxhaj – Pobërgjë (3 familje) -         | Hysen Teshi (14 anëtar)   |
| 8. Sadri Ferizaj – Strelc i Ulët (1 familje) -     | Çerçiz Musaku (3 anëtar);   |
| 9. Zenel Mushkolaj – Irzniq (1 familje) -          | Azem Kerri (9 anëtar);  |
| 10. Fadil Tolaj – Pobërgjë (1 familje) -           | Endri Celani (4 anëtar);  |
| 11. Avni Mataj – Pobërgjë (1 familje) -            | Gent (4 anëtar).  |

**Ndërsa familjet të cilat kanë shprehur gatishmërinë për të strehuar familjet e prekura nga fatkeqësia natyrore (termet) në shteti e Shqipërisë janë:**

1. Blerim Ahmaxhekaj – Prishtinë (një familje)
2. Mergim Tetaj – Llukë e Ulët (një familje)
3. Afrim Lataj – Deçan (një familje)
4. Selmon Jusaj – Strelc i Ulët (dy familje)
5. Imer Ademaj – Ratishë i Epërm (dy familje)
6. Shaqir Dabiqaj – Prilep (një familje)
7. Bedri Kukalaj – Prilep (një familje)
8. Avdyl Mushkolaj – Deçan (një familje)
9. Agron Muslijaj – Piskot – Gjakovë (dy familje)
10. Halil Loshaj – Carrabreg i Epërm (një familje)
11. Hasim Haradinaj – Glllogjan (një familje)
12. Zeqë Malaj – Glllogjan (një familje)
13. Avni Kuçi – Deçan (dy familje)
14. Ajet Kuçi – Deçan (një familje)
15. Isa Tishukaj – Isniq (një familje)
16. Pjetër Bezhi – Dol- Gjakovë (një familje)
17. Afrim Demhasaj – Deçan (dy familje)
18. Enver Likaj – Carrabreg i Ulët (një familje)
19. Islam Tetaj – Llukë e Ulët (dy familje)
20. Valdet Ismajli – Deçan (dy familje)

21. Kadri Tahirukaj – Llukë e Epërme (4 persona)
22. Albert Zenaj - Irzniq (1 familje)
23. Agonis Babanaj – Llukë e Epërme (1familje)
24. Riza Likaj – Carrabreg (1familje)

Familja e fundit me datë 09.12.2019 është kthyer në shtetin e Shqipërisë.